

Tirane më 04.03.2026

### *Ftesë për Ofertë*

**ME OBJEKT:** Kontraktimi i një eksperti /grup ekspertësh / kompanie për zhvillimin e trajnimeve për profesionistët lokalë mbi ‘ Hartimin dhe implementimin e fushatave ndërgjegjësuese për rekrutimin e familjeve kujdestare’, në kuadër të projektit rajonal ‘*E drejta për një familje II – Përmirësimi i disponueshmërisë, aksesueshmërisë dhe cilësisë së familjeve kujdestare dhe shërbimeve të bazuara në komunitet në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë*’,

#### **1. Për Shoqatën SOS Fshatrat e Fëmijëve, Shqipëri**

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri (SOS AL) është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse dhe anëtare aktive e Federatës SOS Fshatrat e Fëmijëve, e përbërë nga 136 shoqata të pavarura kombëtare. Ne punojmë së bashku me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri. Që nga viti 1995, SOS Shqipëri operon në fushën e mbrojtjes sociale duke ofruar shërbime përkujdesjeje për fëmijët pa kujdes prindëror, shërbime parandaluese të bazuara në komunitet për familjet në nevojë dhe fëmijët e tyre, përgatitje për largim nga kujdesi dhe shërbime mbështetëse për të rinjtë. SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri në mënyrë aktive, merr pjesë në advokim dhe mbron të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve që janë në rrezik social. Ne punojmë ngushtë me vendimmarrësit, institucionet qeveritare, organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e shërbimeve sociale dhe i kushtojmë rëndësi të madhe përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve në proceset vendimarrëse.

#### **2. Përshkrimi I Projektit**

Në Shtator 2025, SOS Fshatrat e Fëmijëve, përkatësisht SOS Shqipëria, SOS Maqedonia e Veriut, SOS Ukrainë, SOS Bjellorusia dhe SOS Armenia filluan zbatimin e Projektit “*E drejta për një familje II – Përmirësimi i disponueshmërisë, aksesueshmërisë dhe cilësisë së familjeve kujdestare dhe shërbimeve të bazuara në komunitet në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë*”, i cili synon të përmirësojë të drejtat e fëmijëve me fokus të veçantë në mbështetjen e shërbimit të kujdestarisë familjare dhe reformës së sistemeve të kujdesit alternativ në këto 5 vende të synuara. Projekti financohet nga Ministria Federale Gjermane për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim dhe agjencia zbatuese është SOS Fshatrat e Fëmijëve Ndërkombëtarë.

**Objektivi i projektit** : Fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror ose që janë në rrezik ta humbasin atë, si dhe familjet e tyre, përfitojnë nga një sistem i kujdestarisë familjare dhe shërbime sociale të bazuara në komunitet që janë cilësore, të aksesueshme, të qëndrueshme dhe të koordinuara, të cilat promovojnë mirëqenien, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre.

*Kohëzgjatja e projektit është prej 1.09.2025 – 30.04.2029*

Në kuadër të projektit që synon mbështetjen dhe promovimin e shërbimit të Kujdestarisë Familjare, parashikohet forcimi i kapaciteteve të profesionistëve lokalë nga katër bashki të përzgjedhura në Shqipëri ( Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër). Një komponent kyç i projektit është zhvillimi i trajnimeve për profesionistët në lidhje me planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e fushatave ndërgjegjësuese, me fokus rekrutimin dhe mbajtjen e kujdestarëve familjarë.

### 3. Qëllimi i ekspertizës

Eksperti/ekspertët/kompania do të ofrojë trajnimet për profesionistët lokalë me synim rritjen e njohurive dhe aftësive së tyre në lidhje me procesin e planifikimit, zbatimit, dhe monitorimit të fushatave ndërgjegjësuese, me fokus rekrutimin dhe mbajtjen e kujdestarëve familjarë. Trajnimi duhet të përfshijë të gjitha njohuritë përkatëse për elementët që lidhen me të gjitha fazat në të cilat kalon një fushatë ndërgjegjësimi për kujdestarinë familjare dhe implementimin e saj praktik në nivel lokal. Trajnimi duhet të përfshijë edhe perspektivën gjinore që është thelbësore për të siguruar që fushatat të jenë të ndjeshme ndaj rolit të grave dhe burrave në kujdesin familjar dhe të shmangin stereotipet gjinore. Eksperti/kompania e përzgjedhur do të angazhohet për të zhvilluar 4 trajnime 3-ditore, me nga 15 pjesëmarrës secili, për një total prej të paktën 60 profesionistësh lokalë nga katër bashki të synuara. Trajnimet do të bazohen në:

- udhëzuesin rajonal të zhvilluar në kuadër të projektit të mëparshëm (i përkthyer në shqip),
- mësimet e nxjerra nga zbatimi i aktiviteteve të ndërgjegjësimit në kuadër të të njëjtit projekt,
- nevojat konkrete të profesionistëve në nivel lokal.
- eksperiencën e trajnerit në fushën respektive

### 4. Qëllimi i trajnimit

Të pajisë profesionistët lokalë me aftësi, strategji, mjete dhe teknika për:

- Diferencimin midis fushatave të përgjithshme të ndërgjegjësimit dhe fushatave të targetuara për rekrutimin e prindërve kujdestarë.
- Hartimin e një strategjie për rekrutimin dhe mbajtjen e familjeve kujdestare, të bazuar në analizën e nevojave lokale, perspektivën e fëmijës dhe barazinë gjinore.
- Planifikimin dhe zbatimin e fushatave të targetuara, të fokusuar te nevojat e fëmijëve.
- Mbajtjen dhe mbështetjen afatgjatë të familjeve kujdestare.
- Integrimin e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe rekrutimit në planet vendore të shërbimeve sociale, për të siguruar qëndrueshmërinë.
- Përdorimin e praktikave të mira për rezultate të suksesshme.
- Dokumentimin e mësimëve të nxjerra gjatë implementimit të fushatave të ndërgjegjësimit dhe rekrutimit.

### 5. Objektivat specifike

Trajneri duhet të:

- Shpjegojë kuadrin ligjor dhe politikat mbi kujdesin alternativ.
- Trajnojë pjesëmarrësit mbi teknikat e marketingut social dhe komunikimit publik.
- Shpjegojë dallimin midis fushatave të përgjithshme dhe atyre të targetuara, duke ofruar shembuj praktikash të mira.
- Pajisë pjesëmarrësit me aftësi për të hartuar një strategji të komunikimit dhe mbajtjes së familjeve kujdestare, duke përfshirë objektivat, target-grupet, mesazhet, aktivitetet dhe indikatorët matës.
- Shpjegojë si të shmangen stereotipet gjinore dhe si të promovohet barazia në mesazhet e fushatës.
- Pajisë pjesëmarrësit me aftësi për monitorimin dhe vlerësimin e fushatave.
- Ofrojë mjete për monitorimin e ndikimit të fushatave nga perspektiva gjinore.

- Pajisë pjesëmarrësit me aftësi dhe mjete për të dokumentuar mësimet e nxjerra gjatë implementimit të fushatave të ndërgjegjësimit dhe rekrutimit.
- Mbështesë përfaqësuesit e bashkive në përdorimin e njohurive për hartimin e një fushate dy-vjecare.
- Të ofrojë udhëzime praktike për integrimin e aktiviteteve të ndërgjegjesimit dhe të rekrutimit në planet vendore.
- Ndajë praktika të mira dhe raste konkrete nga vende të tjera ose nga eksperiencia lokale.

## 6. Përmbajtja e trajnimit

- Kuadri ligjor dhe institucional për kujdesin alternativ
- Strategjitë e komunikimit dhe sensibilizimit
- Diferencimi i fushatave të përgjithshme dhe të targetuara
- Hartimi i një strategjie për rekrutimin dhe mbajtjen e familjeve kujdestare
- Planifikimi dhe menaxhimi i fushatave
- Ndjeshmëria kulturore, perspektiva e fëmijës dhe perspektiva gjinore
- Ndërtimi i besimit me komunitetin
- Mbështetja e familjeve të interesuara gjatë procesit të aplikimit dhe mbajtja e familjeve kujdestare
- Praktika të mira dhe mësimet të nxjerra, dokumentimi i tyre.
- Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të fushatës, përfshirë analizën gjinore.
- Integrimi i fushatave në planet vendore për qëndrueshmëri.

## 7. Metodologjia

- Prezantime teorike
- Ushtrime praktike dhe role-play
- Studime rastesh konkrete
- Diskutime në grup dhe reflektime mbi barazinë gjinore dhe perspektivën e fëmijës
- Simulime për hartimin e një fushate 2-vjecare.
- Punë në grup për të draftuar elementë të një strategjie konkrete për rekrutimin e familjeve kujdestare.
- Punë në grup për të draftuar ide mbi integrimin e aktiviteteve të rekrutimit në planet vendore

Trajneri do të përdorë edhe instrumente të vlerësimit (pre and post test) për të matur nivelin e njohurive dhe aftësive të pjesëmarrësve. Rezultatet do të analizohen nga trajneri dhe do të përfshihen në raportin përfundimtar si evidencë e progresit të arritur.

## 8. Rezultatet e pritshme dhe produktet konkrete

### (i) Rezultatet e pritshme

- Rritje e kapaciteteve të profesionistëve lokalë për planifikimin, implementimin dhe monitorimin e fushatave për rekrutimin e kujdestarëve familjarë.
- Qasje e unifikuar dhe e koordinuar ndërbashkiake për komunikimin mbi kujdestarinë familjare.
- Përmirësim i cilësisë së fushatave të rekrutimit të familjeve kujdestare.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial ndërmjet aktorëve lokalë dhe institucioneve të mbrojtjes së fëmijëve.
- Bazë e qëndrueshme për planifikimin dhe zbatimin e fushatave dyvjeçare lokale.

- Dokumentim i mësimëve të nxjerra gjatë implementimit të fushatave, si bazë për zhvillimin e udhëzuesit final për rekrutimin e prindërve kujdestarë.

## **(ii) Produktet konkrete**

- Programi i detajuar i trajnimit, i ndarë në module në përputhje me përmbajtjen e trajnimit të përshkruar më sipër.
- Materialet e trajnimit (prezantimet, ushtrime, instrumenta të ndryshëm etj).
- Pre dhe post test për pjesëmarrësit, të hartuar nga trajneri, për të matur nivelin e njohurive para dhe pas trajnimit.
- Analiza e rezultateve të pre-test dhe post-test, për të vlerësuar progresin e pjesëmarrësve dhe efektivitetin e trajnimit.
- Raporti përfundimtar i trajnimit, duke përfshirë edhe rekomandime për fushatat 2-vjecare të bashkive.
- Udhëzime praktike për integrimin e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe rekrutimit në planet vendore, për të siguruar qëndrueshmërinë.
- Një kornizë strategjike model për rekrutimin dhe mbajtjen e familjeve kujdestare, që mund të përshtatet nga bashkitë sipas kontekstit lokal.
- Udhëzime praktike për mënyrën e mbledhjes dhe analizimit të mësimëve të nxjerra, duke përfshirë edhe formate që do të përdoren për dokumentim gjatë fushatave.

## **9. Kohëzgjatja dhe afati kohor**

Eksperti/kompania pritet të angazhohet në një total prej 15 ditë pune, të cilat përfshijnë:

- përgatitjen
- zhvillimin e trajnimeve dhe materialeve të trajnimit
- dhe raportimin përfundimtar.

Trajnimet do të zhvillohen në periudhën Mars -15 Prill 2026.

## **10. Gjuha e trajnimit**

Trajnimi dhe të gjitha materialet e trajnimit do të ofrohen në gjuhën shqipe.

## **11. Kriteret :**

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në shkencë sociale, psikologji, punë sociale, edukim, komunikim ose fusha të ngjashme;
- Të ketë eksperiencë të paktën 5 vitet e fundit në ofrimin e trajnimeve të tjera në këtë fushë dhe/ose trajnime të ngjashme;
- Përvojë e dokumentuar profesionale në fushën e kujdestarisë familjare dhe/ose mbrojtjes së fëmijëve;
- Përvojë në dizajnimin dhe zhvillimin e trajnimeve për profesionistë, duke përdorur metodogji interaktive;
- Njohuri dhe eksperiencë mbi fushatat ndërgjegjësuese dhe rekrutimin e kujdestarëve familjarë;
- Njohuri të legjisllacionit në fushën e mbrojtjes sociale dhe praktikave që lidhen me kujdestarinë familjare.
- Aftësi shumë të mira lehtësimi, komunikimi, organizimi dhe raportimi;
- Aftësi të mira të menaxhimit të grupit
- Përvoja e mëparshme e punës me autoritete lokale përbën avantazh.

- Njohuritë dhe eksperiencia në integrimin e perspektivës gjinore dhe të fëmijës në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e fushatave sociale përbën avantazh.
- *Angazhimi i ekspertit/ekspertëve sipas këtij Termi të Referencës i nënshtrohet respektimit të plotë të masave kufizuese të zbatueshme të vendosura nga Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian në lidhje me luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar.*

## 12. Kostot që do të mbulohen nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri

Transporti për në Korçë, Vlorë dhe Shkodër, akomodimi, dreka gjatë ditëve të trajnimit, si dhe materialet kancekrike të nevojshme për organizimin e trajnimit do të mbulohet nga SOS Shqipëria. Të gjitha kostot e tjera që nuk përmenden më sipër mbulohen nga eksperti/kompania.

## 13. Dokumentacioni që duhet dorëzuar:

### • Ne rastin e kompanive:

- CV-ne e kompanise dhe ekspertëve
- Letër interesi
- Metodologjia e trajnimit
- Evidenca të punëve të mëparshme në këtë fushë dhe/ose në fusha të ngjashme.
- Ofertën Financiare e cila duhet të përfshijë çmimet në Lek me TVSH. Për ofertën financiare ju lutemi, përdorni Formularin e Ofertes bashkangjitur kësaj Ftese për oferte.
- Kopje NIPT
- Kopje të Ekstraktit Historik, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit jo më parë se një muaj.
- Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve tatimore jo më herët se një muaj nga data e aplikimit.  
***Oferta duhet të jete e vlefshme deri ne date 31.04.2026***

### • Ne rastin e ekspertit/grup ekspertesh:

- CV në gjuhën shqipe
- Letër interesi
- Metodologjia e trajnimit
- Evidenca të punëve të mëparshme në këtë fushë dhe/ose në fusha të ngjashme.
- Propozimi financiar të plotësuar dhe i nënshkruar sipas Formularit të Ofertes bashkangjitur kësaj Ftese për Oferte. Ju duhet të propozoni tarifën tuaj ditore në shumën bruto, e cila do të përllorarit me numrin e ditëve të punës për të përcaktuar shumën totale të kontratës. Nga kjo shume do te mbahen dhe paguhen detyrimet ne baze te Legjislacionit ne fuqi te Shtetit Shqiptar.

- *Norma e tarifës ditore bruto duhet të jete ne monedhen Lek.*

- ***Oferta duhet të jete e vlefshme deri ne date 31.04. 2026***

## 14. Skema e pageses

Pagesa do të bëhet në dy këste ( 50% secili këst):

- (i) pas perfundimit te trajnimeve;
- (ii) pas dorëzimit të raportit final dhe aprovimit të tij nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri. *Pagesa do të bëhet nëpërmjet transfertës bankare sipas detajeve të përcaktuara në kontratë.*

## 15. Paraqitja e propozimit

Afati i fundit për dorëzimin e propozimit është **11 Mars 2026** . Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet në adresën e mëposhtme e-mail: [info@soskd.org.al](mailto:info@soskd.org.al)

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Ofertuesi]

## FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit/ \_\_\_\_\_, Qyteti: \_\_\_\_\_

Për: SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri

Procedura e prokurimit: “ **Kontraktimi i një eksperti /grup ekspertësh / kompanie për zhvillimin e trajnimeve për profesionistët lokalë mbi ‘ Hartimin dhe implementimin e fushatave ndërgjegjëse për rekrutimin e familjeve kujdestare’** , në kuadër të projektit rajonal **‘E drejta për një familje II – Përmirësimi i disponueshmërisë, aksesueshmërisë dhe cilësisë së familjeve kujdestare dhe shërbimeve të bazuara në komunitet në Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Maqedoninë e Veriut dhe Ukrainë’** ,

Tarifa Ditore Bruto:.....Lek

Numri total i diteve te trajnimit:.....Dite

Tarifa Totale Bruto: .....Lek

**Konfirmoj se tarifa ditore e vendosur eshte ne vleren bruto dhe perfshin te gjithe detyrimet per tu mbajtur dhe paguar ne baze te Legjislacionit ne fuqi te Shtetit Shqiptar.**

Oferta eshte e vlefshme per minimumi \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_.

Vula \_\_\_\_\_.